

## AKT- THEMELIMI

### I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE

#### KUFIZUAR

#### “BIG CITY” Sh.p.k.

Shoqeria **“BIGALB GROUP” shpk.** Person Juridik shqiptar i regjistruar si i tille prane Regjistrimit Tregetar ne QKB, pajisur me Nipt **L11521002M** dhe seli ne Tirane, Vaqarr, Fshati Gropaj, Godina Tirana Cash & Carry, kati 2. Me perfaqesuese Ligjore Znj. Elona Koshi, e bija e Tekiut, e dtl. 04.09.1986, e lindur ne Gramsh dhe banuese ne Tirane Rruga “3 Deshmoret”, Yzberisht. Madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. 033400499 leshuar me date 06.06.2017.

Ne baze te legjislacionit shqiptar ka vendosur me vullnetin e lire dhe te plote, marreveshjen per themelimin e shoqerise tregtare private, me pergjegjesi te kufizuar, te emertuar **“BIG CITY” Sh.p.k.** e cila do te rregullohet ne mbeshtetje te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe normave qe vijojne:

#### **Neni 1**

Te themeloje nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar e quajtur **“Big City” Sh.p.k.** **“Big City” Sh.p.k.** eshte nje subjekt juridik Shqiptar, te cilit i lind e drejta te ushtroje aktivitetin qe nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB). Shoqeria **“Big City” Sh.p.k.** zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit te saj.

#### **Neni 2**

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive tregtare me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbjet sipas ligjit.

#### **Neni 3**

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete:

- Import-eksport, tregtimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve, me shumice dhe pakice si:
- Tregtim artikuj te ndryshem industrial.
- Tregtim artikuj te ndryshem ushqimore.
- Tregtim artikuj te ndryshem bujqesore e blegtorale.



- Tregetim fruta-perime.
- Tregetim pije alkalike te ndryshme.
- Tregetim konfeksione te ndryshme per te rritur dhe femije.
- Tregetim prodhimesh kozmetike e estetike.
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit.
- Tregetim automjetesh te cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to.
- Tregetim, montim, riparim paisjesh elektro-shtepiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, paisje zyresh etj.
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, diskotekash, lojra argetuese per femije, qender sportive, qendra pushimi e kurative.
- Tregetimin e karburanteve te ndryshem me pakice, si dhe vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje, pajisje ngrohese gazi si dhe mbushjen e bombolave te gazit dhe tregetimin e tyre me pakice.

#### Neni 4

- Shoqeria **“Big City” Sh.p.k.** ka seline ne adresen: *Autostrada Tirane – Durres, Km. 12, qendra tregatre “City Park”, kati zero, Gjokaj –Tirane.*

#### Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise **“Big City” Sh.p.k.** do te jete **30.000.000 (tridhjetë milione) leke** dhe eshte i perbere nga shuma ne te holla e derdhur nga ortaku.

#### Neni 6

Kuota e pjesmarrjes eshte si me poshte:

1. Shoqeria **“BIGALB GROUP” sh.p.k.....** 1 kuote me vlere te pergjithshme **30.000.000 leke (tridhjetë milione)** qe perben 100 % (njqind) te kapitalit themeltar te shoqerise.

#### Neni 7

Kohezgjatja e shoqerise **“Big City” Sh.p.k.** do te jete me afat te pacaktuar. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te ortakut.

#### Neni 8

I gjithe kapitali i vene nga ortaku themelues eshte teresisht dhe plotesisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem.

#### Neni 9

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne Shoqerine Tregetare do te shenohet dhe kapitali i derdhur nga ortaku. Rritja e kapitalit themelor te shoqerise nuk eshte e kufizuar.



#### **Neni 10**

Te ardhurat e realizuara nga shoqeria do te ndahen pjeserisht ose totalisht ortakut sipas kuotes se pjesemarrjes ne kapitalin themeltar si dhe nepermjet akteve te tjera noteriale apo kontratave te punes qe do te realizoje, pasi te jete lene nje shume menjane te pakten sa nje e njezeta e tij e cila destinohet per formimin e fondit rezerve.

#### **Neni 11**

Ne kohen e prishjes se shoqerise ose te perfundimit te afatit, kur nuk ka zgjatje afati kapitali i shoqerise pasi te hiqen debite e saj do t'i ndahet ortakut sipas kuotes se pjesemarrjes ne kapitalin themeltar.

#### **Neni 12**

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqerise, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe ato qe kane lindur me te tretet, eshte plotesisht i transferueshem dhe per tu depozituar ne nje nga Bankat Shqiptare, ose per tu perdorur sipas nevojave te ortakut te shoqerise.

#### **Neni 13**

Ortaku ka keto te drejta dhe detyra themelore:

- te derdhi kuoten e kapitalit baze sikunder eshte percaktuar ne nenin 6,
- te marri pjese ne drejtimin e shoqerise,
- te terheqi fitimin e realizuar,
- te terheqi aktivin resultant nga bilanci i likujdimit ne rast te pushimit te aktivitetit te shoqerise,
- te ruaje sekretin e aktivitetit te shoqerise,
- te impenjohet per arritjen e objektivave te shoqerise.

#### **Neni 14**

Organet e shoqerise "**Big City**" Sh.p.k. jane:

- Asambleja e Ortakeve te shoqerise
- Administratori i shoqerise.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne statutin e shoqerise  
Administrator i shoqerise do te jete **Z. Robert Hoxha**, banues ne Tirane, per nje afat 5 vjecar.

#### **Neni 15**

Shoqeria tregtare private "**Big City**" Sh.p.k. eshte person juridik shqiptar dhe do te ushtroje veprimtarine e saj ekonomike private ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht ligji 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe ligji Nr.9723 date



03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te K. Civil si dhe te akteve ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

**Neni 16**

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit, qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te ligjit Nr.7961,date 12.07.1995 (KODIT TE PUNES), si dhe akteve te tjera ne zbatim te tij.

**Neni 17**

Mosmarveshjet e mundeshme qe mund te lindin gjate interpretimit apo zbatimit te kesaj kontrate palet do ti zgjidhin ne rruge miqesore, ne te kundert kompetencat per zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

**Neni 18**

Per sa nuk pershkruhet ne kete kontrate themelimi do te aplikohen nenet e statutit te shoqerise dhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.

**Neni 19**

Ky Akt-themelimi eshte perpiluar ne kater kopje origjinale.

Date 03/10, 2018

**ORTAK THEMELUES**

**BIGALB GROUP Sh.p.k.**

**Elona KOSHI**



**Perfaqesues Ligjor**